



2015

RAPORT- TM₄ -2015



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A


Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	5
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	6
2.1 Aktivitetet – Tetor - Dhjetor 2015	6
2.2 Prodhimi i ujit m ³	10
2.3 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	11
2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim	11
2.5 Servisimi I ujëmatësave	12
2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	14
2.7 Raport per trajtimin e ujërave te zeza	15
2.8 Raport i Aktiviteteve te Njesive	19
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	24
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	24
3.2 Aktivitetet e shërbimit te kontrolles	25
3.3 Pengesat ne realizimin e objektivave	26
3.4 Masat e realizuara	26
3.5 Planet për të ardhmen	26
3.6 Raport I mediave	27
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	25
4.1.1 Aktivitetet – Tetor- Dhjetor 2015	31
4.1.2 Personeli	33
4.1.3 Raport I puneve te kryera nga gjykatat	34
4.1.4 Raport i zyrës për mbyqyrje dhe siguri në punë	41
V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	41
5.1 Aktivitetet – Tetor - Dhjetor 2015	41
5.2 Shpenzimet – Tetor - Dhjetor 2015	42

VI.	RAPORT	I PERFORMANCAVE OPERATVE DHE FINANCIARE TM3/TM4 -2015	44
VII.	RAPORT	I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT	49
VIII.	RAPORT	I AUDITORIT TË BRENSHËM	51
		ORGANOGRAMI	53

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



FURNIZIMI

Furnizimi me uje te pijes ne nivel regjional ka qene i rregullt, nepër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në TM- 4, të vitit 2015 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (Kryesisht te lagja Dardanisë, pjesa e Bazhdarhanës dhe në rrugën e Janinës). Në njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi patur furnizim të rregullët me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për TM- 4, të vitit 2015 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **4,070,139 m³**, krahasuar nga TM paraprak kemi një zvoglim të prodhimit të ujit të pijes prej **940,620 m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

FATURIMI

Në periudhën e TM4 - 2015 janë faturuar 1.713.782 m3, apo 18.65% më pak se në TM3-2015
Faturimi në Euro në TM4- 2015 ka qenë 996.772,33 €, në krahasim me TM3 - 2015 ka pas një rënie prej 15.27%

INKASIMI

Në periudhën e TM4 -2015 janë inkasuar 844.755,34 € , apo 1.14% më pak se në periudhën TM3 -2015.
Përqindja e inkasimit ishte 85.53% ose 12.54% më e lartë se në periudhën TM3 - 2015

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha sherbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha sherbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe instutucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tijë është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.

Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogëlimin e UPF-së dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Raportet tregojne që UPF në nivel regjional për TM- 4, të vitit 2015 është **57,89 ose 0.07%** me zvoglim të UPF nga TM-3.

SHPENZIMET

Shpenzimet në periudhën e TM4- 2015 arrinë në 874.780,65 € apo 14.08% më të larta se në periudhën TM3 -2015.

MBULIMI OPERATIV

Si rezultat i rënies së inkasimit prej 9.701,32 €, si dhe rritjes të shpenzimeve prej 107.940,65 €, për periudhën TM4- 2015 kompania nuk ka arritur të kishte mbulim operativ pozitiv 0.97- (-30.025,31 €)

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK**2.1 Aktivitetet - Tetor- Dhjetor – 2015**

- *Dergimi i Pelqimit te MI-se tek konsulenca dhe punekryesi,
- *Dergimi i pelqimit per pjesen e dyte te projektit tek kontraktori ALFA-I,
- * Takim me Konsulencen me Molnarin per statusin e fazes II qe do te raportohet per delegacionin e KfW-se,
- *Perpilimi i raportit per delegacionin e KfW-se,
- *Takim me pronarin e pompes BADALLAJ per nderprerjen e punimeve te Fazes I,
- *Takim me Hilmar Rave ku dhe ju prezantua metoda e PTF-se si metode e avancuar ne aspektin e eficiences se energjise elektrike,
- *Fillimi i pikeimit te terenit nga kompania kontraktueses ALFA-I,
- *Dergimi i raportit te KfW-se tek Fadil Berisha,
- *Evaluimi i tenderit per sigurime-si komision vleresues,
- *Dalje ne vendindpunishte, dhe tek lokacioni i ITUZ-se se bashku me konsulencen dhe drejtorin Financiar,
- *Takim Javor me konsulencen dhe Passavante,
- *Takim me menaxhmentin ne lidhje me shqyrtimin e raportit per KfW-ne,
- *Takim me delegacionin e KfW-se ne lidhje me shqyrtimin e projekteve te financuara nga KfW,
- *Dalje ne vendin e punimeve te projektit per Fazen I, se bashku me Delegacionin e KfW-se dhe Konsulncen,
- *Takim me ALfa -I per vendosjen e pompes shtytese,
- *Dergimi i pageses per AQUALIA tek Konsulanca,
- *Takim ne Prishtine ne MMPH-per permbylljen e projektit per menaxhimin e thatesirave,
- *Vazhdimi i evaluimit per tenderin e sigurimeve,
- *Takim ne Shkup ne prezantimin e kompanive Sllovene dhe Kroate per aplikimin e GIS-it,
- *Takim me Drejtorine e sherbimeve publike per ndalesen e punimeve ne projektin e ujerave te zeza nga banoret e shpronesuar,
- *Intervista me shkrim e kandidatit per koordinator te operatives dhe mirembajtjes ne Suhareke,
- *Takim me kryeshefein per mundesine e vendosjes se pompes shtytese ne lagjen Dardania,
- *Dalje ne vendin ku do te vendoset pompa shtytese ne lagjen dardania,
- *Takim me konsulencen per zhvillimin e punimeve per fazen I dhe diskutim per fazen II,
- *Dergimi i kerkeses per Njesite Punuese per planifikimin e investimeve per prokurim ne vitin 2016,
- *Takimi i Menaxhmentit te kompanise.
- *Perpilimi i raportit TM3 ne sherbimin teknik,
- *Dalje ne vendin e punimeve ne Vlashne te ujerat e zeza per shkak te nderprerjeve te punimeve dhe lajmrimi ne policine e Kosoves.
- *Takim me drejtorin e arsimit dhe drejtorin e shkolles Xhevat Berisha, per vendosjen e pusetes ne lokacionin e shkolles,
- *Mbajtja e intervistes me shkrim per konkursin e inxhinierit ne GIS,
- *Perpilimi Planit te Biznesit investimet 2016,2017,2018,

- *Perpilimi i raportit per TM3 2015,
- *Takim me banoret e fshatit Billush dhe Poslisht per mundesine e investimeve shtese dhe futjen nen menaxhim te HRJ-se,
- *Takim me komplet stafin teknik me inxhinieret dhe punetoret teknik, per mbarevajtjen e puneve ne projektin qe eshte duke e implementuar ALFA-I,
- *Takim me ZRRUK me Samiun dhe Vehbi per shqyrtimin e performances per gjysme vjetorin e vitit 2015,
- *Dalje ne vendin ku jane duke u zhvilluar punimet tek projekti i MZHE-se,
- *Shyrtimi i pelqimit per monumentet historike ne MKRS,
- *Intervista me goje per kandidatet te cilet e kan kaluar pjesen me shkrim per pozicionet sipas konkursit per inxhinieret ne Prizren dhe Suhareke,
- *Perfundimi i tabelës së Planit të investimeve për vitin 2016,2017, dhe 2018, dhe dergimi tek zyrtari per raportim,
- *Dalje ne vendpunishte nga stafi Teknik, ne projektin e MZHE-se,
- *Perfundimi dhe dergimi i raportit TM3 tek zyrtari per raportim,
- *Dergimi i certifikates se TVSH-se tek Limani per komoanine AQUALIA,
- *Takim me ALFA I- ne lidhje me mbarevajtjen e projektit dhe menyren e pageses per pjesen e pare,
- *Dalje ne vendin e punimeve te projekti i MZHE-se,
- *Fillimi i pusetes tek Mena - Dardani,
- *Perpilimi i projektit per SKADA sistem qe do te prezantohet ne Sofie,
- *Pergaditja e dokumentacionit per lirim nga taksat dhe doganat per projektin e ujerave te zez a faza i dhe dergimi i tyre ne ministrine e zhvillimit ekonomik te z adem ahmetaj ne Prishtine,
- *Pergaditja e pelqimit per drejtorine e urbanizimit,
- *Pergaditja perfundimtare e materialit qe do te prezantohet ne SOFIE, 28.10.2015 deri me 30.10.2015 Takim ne SOFIE per projektin e IWA-DANUB, ne viziten punuese te cilen e kemi pas ne ujesjellesin e sofies si dhe ne kompanite Private te Sofies.
- *Dalje ne vendngarje tek puseta qe jemi duke e ndertuar ne Dardani,
- *Dy Takime me Kforin Gjerman, njeri ka qene ne lidhje me hidrantat dhe tjetri ka qene me mundesine e lidhjes se nje kontrate per pastrimin e gropave septike te KFORIT
- *Pergaditja e paramases dhe dizajnit per puseten e Dardanise-stacionin shtytes,
- *Takim me AUALINE, KONSULENCEN dhe HRJ-ne per shikimin e dizajnit per Fazen II, ku do te vendoset perfundimisht situacioni i shtrirjes se elementeve per trajtimin e UZ.
- *Takim me Ulrihun per faturat shtese qe u nenshkruan me me nenshkrimin dhe vulen e drejtorit,
- *Takim tre ditor ne Emereald, Ditet e Ujerave SHUKALB
- *Dalje ne vendin e punimeve tek puseta ne lagjen Dardania,
- *Takim me Bordin e Ri te drejtoreeve,
- *Dergimi i investimeve janar-shtator 2015 ne ZRRUK sipas kontabilitetit,
- *Takim ne ZRRUK ne lidhje me ceshtjen e licences se kompanise-Prshtine
- *Takim ne Keshillin nderministror te ujerave,-Prishtine
- *Takim ne MZHE per JICA-Prishtine
- *Dergimi i komenteve shtese per lirim nga Dogana tek Adem ahmetaj ne MZHE per Materialin per Fazen I.
- *Futja e listes se investimeve ne planin e Biznesit,
- *Dergimi i formes se urdherpageses qe duhet ta beje Passavante per lirim nga Dogana per Fazen I, e cila duhet te dergohet ne MZHE,
- *Takim i menaxhmentit per shqyrtimin e raportit per muajin Tetor
- *Takim me zyrtaret e MMPH-se per aplikacionet e lejeve per burimet e reja te cilat duhen si kusht per te vazhduar Licencen.
- *Pergaditja e raportit per muajin Tetor,
- *Mbledhja e Bordit te drejtoreve
- *Takim me Alfa I, per perpilimin e raportit per punet te cilat jane kryer deri me tani per projektin e MZHE-se
- *Takim me MOLNARIN-Konsulencen, per miratimin e ndrrimit te ekspertit te Ujerave te Zeza, me crast dhe u miratua nga ana jone.

*Takim me tekniket e operatives per mundesine e vendosjes se ujematesve ne rruget dytesore tek DURIMI TRADE

*Takim me ALFA I-ne per perpilimin e pozicioneve te pageses per projektin e MZHE-se e cila duhet te paguhet me se largu deri ne funde te ketije muaji.

*Punimi dhe futja e projekteve ne plan Biznesin Rregullatore

*Takim me banoret e lagjes Bazhdarhane, ku dhe ju premtua se brenda 15 diteve do te kete mundesi

*Takim me Drejtorine e Sherbimeve Publike per mundesine e perpilimit te contos se mirebesimit per mundesine e procedimit te projektit ne MMPH-Leja ndertimore VNM.

*Perpilimi i Procesverbalit per punet e kryera ne projektin e MZHE-se dhe dergimi i dokumentacionit ne MZHE.

*Dergimi ne MZHE| i dokumentacionit per pagese per pjesen e pare te Lot 2 per kontraktorin ALFA-I.

*Kerkese drejtuar DSHP-se ne komunene Prizrenit per perpilimin e Kontos se mirebesimit,

*Kerkese per DSHP ne Komunene e prizrenit per pergjigjen ne letren qe e ka dergu KfW por te rejat mbi shpronesimin,

*Njoftim mbi kalljen e aneksit tek dhoma e inkasanteve, ku rreth ores 03:38, jam njoftuar me telefon nga Udheheqesi i Njesise Punuese ne Prizren z Shefkat Halimi, menjere kam dal ne vendin e ngjarjes ne Objektet e kompanise dhe kam verejtur se prezent ishin Zjarrefiksiti dhe Policia e Kosoves, zjarri dhe perpjekjet per loklazimin e zjarrit kan zgjatur rreth dy ore me crast dhe rreth ores 5 e 30 te mengjesit pothuajse eshte shuar komplet zjarri.

Pas kontrolles brenda objekteve te cilat i kemi vezhguar sebashku me z Shefkat Halimi kemi verejtur se tek dera kryesore e Kontistit te industrise dhe Arkatarit ka shenja te thyerjes se dyerve si dhe jane verejtur disa fijoka te hapur po ashtu dhe shenje nga mjete te forta ne Arken e cila gjendet brenda zyres se arkatarit, po ashtu edhe dera e portoarkes kryesore e demtuar nga mjete te forta si dhe disa fijoka te hapur, menjehere e kemi njoftuar policine e cila ishte prezente dhe ata rreth ores 07:00 jane marre me hetimet e duhura te vendit te ngjarjes.

Sa i perket demeve te shkaktuar si shkak i zjarrit une siperfaqesisht aq sa kam mundur te vereje kam konstatuar se perpos djegjes se dokumentacionit qe ka qene ne ate zyre eshte demtuar edhe nje panel elektrik si dhe eshte djegur komplety zyrja.

Policia ka bere hetimet paraprake po ashtu edhe ekipa preventive e zjarrefikesve kane bere hetimet e para, dhe ne kohen ne vijim pritet te dalin raportet preleminare ne lidhje me demin e shkaktuar material dhe administrativ.

*Vlene te ceket se deme ne njerez nuk ka pasur.

*Takim emergjent i menaxhmentit per formimin e komisionit te vleresimit te demeve per shkak te kalljes se anexit te inkasanteve ne Objektin Qendror te kompanise.

*Takim me Kompanite punerkyrese te projektit nga MZHE, me kompanone ALFA-I dhe XERXA, me te cilet u dikutua ne lidhje me fillimin e porjektit per Lot I dhe Lot 2, ku dhe u dakordua se fillimi i punimeve do te jete me sa largu deri me ditene hene me date 30.11.2015, u diskutua dhe per nje bashkpunim me rigoroz nga ana e kompanise tone pasi qe projekti per shkak te voneses se pelqimeve nga ana e ministrise se Kultures na ka shkaktuar vonesa ne implementim,

*Venja e projekteve ne Plan Biznesin Rregullator,

*Takim me Konsulencen dhe punekryesin per Fazen I, ku u diksutuar per:

-Prokurimi i materialit dhe shperndarja ne vend,

-Statusi i kontraktuasit, instalimet, vizatimet dhe punet e kryera,

-Ripunimi i orarit te aktiviyeteve per vitin 2016

*Vleresimi i punetoreve per vitin 2015, Lumni Sallahu, Ismet Kurtishaj, Shefkat Halimi, Njazi Bytyqi dhe Qakixhi Tershnjaku.

*Plotesimi i kerkeses per MZHE ne lidhje me lirimin nga TVZH dhe taksat tjera per kompanine Alb Architect,

*Plotesimi i dokumentacionit shteses per MZHE-ne per terheqjen e mjeteve te pjeses se pare te projektit qe eshte duke e punuar ALFA-I,

*korrigjimi i ketyre kerkesave te cilat do te dergohen ne MZHE tek Adem Ahmetaj ne MZHE.

- *Takim ne MZHE, dorezimi i dokumentacionit per Alb Architect tek Adem Ahmetaj dhe dergimi i Pranimit Teknik dhe auditimin e projektit tek Fidaim Spahiu,
- *Takim ne Ministrine e Financave me Lum Miten, per sqarimin e Tvsh-se dhe Taksave Doganore,
- *Takim me menaxhmentin per organizimin dhe pergaditjen e dokumentacionit per KFW-ne.
- *Takim ne Prishtin me zyren ligjore te doganave, me Krenare Shala.
- *Takim ne Ferizaj me doganen, me Agim Nika, per sqarimin e konfirmimit nga MZHE.
- *Takim ne MZHE me Adem Ahmetaj, per formulimin e shkreses qe nevoitet per Doganen e Kosoves per lirim nga TVSH dhe Dogana.
- *Nenshkrimi I fatures se pare per Fazen I Task A dhe Task B per Passavanten,
- *Fillimi I rregullimit te dokumentacionit per KFW-ne ne takimin e radhes.
- *Njoftim I zyres konsulente per dergimin e pyetsorit nga KFW, ne lidhje me Shpronsimin e pronave te ITUZ-se ne DSHP, Komuna Prizren.
- *Takim me Vera Muhaxhirin dhe Zoge Spahiu ne lidhje me aplikimin e rregullave te reja te ZRRUK-ut.
- *Pergaditja e raportit per MMPH- zevendesministri.
- *Takim me Zv ministrin e MPH-se ku u raportua per projektin e ujrave te zeza ne Prizren dhe kishim vizita ne teren ne vendin e punimeve.
- *Dalje ne vendin e punimeve tek ETC-ja FAza I, projekti I ujrave te zeza.
- *Takim me delegacionin e KFW-se per pergaditjen e grantit bashkefinansues ne mes te KFW-se dhe qeveris per Prizren-Peje dhe Gjakov per rehabilitimin e rrjetit te kanalizimit.
- *Takim me Kforin, Komunen dhe Njesin e zjarrfiksave, per hapjen e tenderit te rregullimit te hidrantave neper qytet dhe formimi I ekipeve per verifikimin te metutjeshme si dhe pergjegjesia e mirembajtje si dhe e menagjimit te hidrantave, urgjent u vendos te ndertohet hidranti I cili eshte hapur nga qytetart e papergjegjshem ne pjesen e lart ku nuk munde te hyje kamioni I zjarrfiksave.
- *Takim me Kforin Zvicrran.
- *Takim me konsulencen per nenshkrimin e fatures se pare per pune kryerje-projektim te AQUALIA per Fazen II.
- *Takim me financjerin e PASSAVANTE Egzon Rrencin per faturen e cila ka te beje me TVSH-ne e mallit dhe taksat doganore per kontigjentin e pare.
- *Takim me Kryshefin Ekzekutiv, per planetditore dhe javore .
- *Takim me Menaxherin Financiar per mundesin e formimit te Taks Forces ne lidhje me ckyqjet e konsumatoreve borgjlinje.
- *Pergaditja e raportit per muajin Nentor
- *Pergaditja e kerkesave per konkurs per dy punetor ne laboratorin e analizave te cilesis se ujit.
- *Takim me perfaqesuesin e AQUALIA, ne lidhje me TVSH-ne dhe taksat tjera, ku dhe u sqarua ne lidhje me kontributin e brendshem ndaj te cilit duhet te paguhet TVSH-ja dhe kontributet te jashtme ndaj te cilit duhet te lirohet nga TVSh-ja dhe taksat tjera.
- *Rregullimi I dokumentacionit per projektin e MZHE-se
- *Nenshkrimi I fatures nr. 2 per pune kryerje IPC 2 per PASSAVANTE-KWE
- *Takim ne ATK me Afrim Demirin per procedimin e projekteve me TVSH dhe Taksa tjera.
- *Pranim Dorzimi I Projektit te Komunes mbi 40 Burimet.
- *Pergaditja e dokumentacionit per investimet e MZHe-se –Furnizimet
- *Takim me Kforin per qeshtjen e nderprerjes se ujit te pijes brenda hapsires se Kforit pra ne bazenin e Kurilles ku Kfori nuk pranonte se e ka nderprereujin, kurse nga kompania jone eshte vertetuar se nderprerjen e ka bere dikush Brenda Kforit pasi qe ne kurrsesi nuk kemi qasje brenda hapsires ku kontrollohet nga Kfori e konkretisht Brenda rezervuarit te Kurilles ku furnizohet komplet pjesa veriore e Prizrenit.
- *Takim ne konferencen e levizjes EC Me NDRYSHE, me ftese te kesaj levizje, me temen per nje qytet te perbashket, ku u diskutua aktivitetet e perbashketa te populates dhe Komunes se Prizrenit mbi projektet te cilat ndikojn drejteperdrejt ne mirqenjen e qytetareve te Prizrenit, sa I perket furnizimit me uje ne konferenc u permend furnizim 24 h lagjes Bazhdarhana dhe furnizimi I rregullt ne pergjethesi me uje te pijes.
- *Dergimi I fatures IPC1 tek Premtim Islami e cila ka qen dashte te paguhet nga Kfwoer fazen 1 tek PASSAVANTE.

- *Dergimi I kopjes se kerkeses qe I kemi bere MZHE-se per lirim nga TVSH-ja per konsulencen ALB Architect.
- *Perpilimi I kerkeses per KRRPP-ne te cilen ja dergova si draft Zyrtarit te Prokurimit, Kryeshefit dhe Zyrtarit kryesor Financiar.*Perpilimi I kerkese se bashku me komplet menaxhmentin per rialokim te mjeteve per projektet e mbetura per vitin 2016 ne MZHE.
- *Kontakti me Premtim Islamin per pagesen e pare te PASSAVANTE dhe dergimin e sqarimit nga Premtimi tek Adem Ahmetaj per lirim nga TVSh-ja dhe taksat tjera.
- *Dergimi I aplikacioneve per leje ujore ne MMPH.
- *Dergimi I miratimit te Klaus Rothe per projektin e masat shoqeruese
- *Montimi I shi-matesit tek 40 Burimet, te cilin e ka prure Instituti Hidrometeorologjik.
- *Shkuarja ne Prokurori me dajen Bes per çeshtje te Anti Korrupsionit per deklarim te gabuar te pasuris.
- *Rishiqim I te dhenave per investimet ne Plan Biznes.
- *Riformulim I te dhenave per investimet te cilat do te shkojn ne prokurim gjate vitit 2016.
- *Perfundimi I futjes se te dhenave ne Plan Biznesin Rregullator per vitet 2016-2018.

*Në këtë TM- 4 janë bërë leximet e ujëmatësve zonal me qëllim për të verifikuar hargjimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

(Për me gjerësisht ekziston raportoni te Kordinatori për Planifikim dhe Zhvillim).

*Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujesjellesit dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqperdorim të ujit të pijes përmes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajn ujë në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

2.2 Prodhimi i ujit m³ - TM-3 / TM4- 2015

TM3- 2015

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	4,005,700.00	43,540.22	503.9	
Suharekë	533,015.00	5,793.64	67.1	
Dragash	129,580.00	1,408.48	16.3	
Malishevë	342,464.00	3,722.43	43.1	
Total	5,010,759.00	54,464.77	630.4	

Prodhimi i ujit m³ - TM-4 / 2015

Muaji	Prodhimi mujor m ³	Prodhimi ditor- m ³	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,209,100.00	34,881.52	403.7	
Suharekë	450,906.00	4,901.15	56.7	
Dragash	65,130.00	707.93	8.2	
Malishevë	345,003.00	3,750.03	43.4	
Total	4,070,139.00	44,240.64	512.00	

2.3 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM-3- TM4- 2015

TM₃- 2015

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	300	261	561
Suharekë	72	25	97
Dragash	22	11	33
Malishevë	113	50	163
Total	507	347	854

TM₄- 2015

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	306	178	484
Suharekë	58	15	73
Dragash	17	02	19
Malishevë	149	56	205
Total	530	251	781

2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim – TM-4, 2015

Për periudhen që po raportojmë në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësave nëpër qytetin e Prizren'it, ku kanë arritur këto rezultate: ujëmatësa të bllombuar 427 ujëmatësa, kontrata të nënshkruar 427 kontrata, konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 525 konsumator, ribllombim bllombim për here të dyte 228, konsumatorët që janë të bllombuar 810, konsumatorët pa ujëmatës 29, konsumatorët që duhet zëvendësuar ujëmatësi 01, rekorde të reja 225, konsumatorët që nuk kanë lidhje uji 364, konsumatorët që duhet regjistruar 23, kërkesa nga konsumatorët për bllombim 02, vendi pa pershtatshem 05.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	427
2	Ribllombim	228
3	Dera Mbyllur(Heren e dyte)	525
4	Jane te bllombuar	810
5	Rekorde te reja	225
6	Nuk kane lidhje uji	364
7	Zevendesim	01
8	Pa ujemates	29
9	Duhet regjistruar	23
10	Kerkes për bllombim	02
11	Vendi i papershtatshem	05

Aktivitetet kryesore:

* Vizit dhe kontroll në lagjen Dardania (verifikim të ujëmatësave gjithsej 135 shtepi).

* Vazhdimi dhe futja e të dhënave në hartat 7E122009, 7E122014, refreshimi i hartave 7E122017, 7E122018, 7E123002, 7E123006 nga tereni. Përgaditja dhe vektorizimi i hartës së lagjës Dardania dhe krijimi i hartës 7E122014 për refreshim.

* Refreshimi i hartave 7F123003, 7F121202, 7E122018, 7F122017, 7E123006 dhe regjistrimi i hartës 7E122014, harta 7E123006 është perfunduar refreshimi, printimi i data basës për hartën 7E122009, regjistrimi i hartës 7E122009 në data basë si dhe bashkepunimi me inkasantët, kontrollimi i data basës në bashkunim me faturimin. Përgaditja dhe printimi i formularëve për teren, regjistrimi i rekordeve të reja të sjellura nga tereni.

* Në muajt Tetor - Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 317 ujëmatësa, ekziston raporti i veçant.

* Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Tetor - Dhjetor, ka bërë gjithësej 132 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 85 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 2,449 m.

* Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Tetor - Dhjetor, ujëmatësat në pikat matëse:

Nashec i eperm, Tupec nuk janë lexuar ujëmatësat (puseta me uje), Sheshi i Lidhjes, Nashec i eperm, Jusuf Gervalla dhe te FSK-ja kemi lexim të ulët të ujëmatësave, Atmaxh lexim i ulët (baypass). Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këta muaj.

* Po ashtu gjatë muajve Tetor – Dhjetor, kemi pasur 12 rast për riparimin e ujëmatësave që janë sjellë nga vete konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

2.5 Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: TM-4, 2015

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit.

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: TM3 - 2015

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	81	
	3/4"	237	
	1"	31	
	5/4"	03	
	6/4"	00	
	Gjithsejt:	352	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	

Dragash	1/2"	11	
	3/4"	31	
	1"	01	
	2"	00	
	Φ 50	00	
	Gjithsejt:	43	
Malishevë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	

395copa

+ 01 ujemates $\frac{3}{4}$ Hoqa Vogel

+ 01 ujemates 1' per Poslisht

Totali: 397 riparime te ujematesave

Plus:

-Leximi i ujëmatësve, 2 x në muaj.

-07 ekspertiza, 04 per KRU "Bifurkacion" Ferizaj

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: TM4 - 2015

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	111	
	3/4"	198	
	1"	21	
	5/4"	00	
	6/4"	00	
	Gjithsejt:	330	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	05	
	3/4"	16	
	1"	01	
	2"	00	
	Φ 50	00	
	Gjithsejt:	22	
Malishevë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	

352copa
+ 81 ujematës 3/4, „Radoniqin“
Totali: 433 riparime te ujematësave

Plus:

- Leximi i ujëmatësve, 2 x në muaj.
- 04 ekspertiza, të ujëmatësave

2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike

Laboratori “Hidroregjioni Jugor”Prizren

Aktivitetet

- *Eliminimi I defektit në injector për klorifikim në Bunarlluk I;
- *Vizita në Prishtinë për furnizim me reagjent dhe paisje në “eraMED”;
- *Ndërrimi I bombolës 1 t në objektin e Mullirit;
- *Vizita në ujësjellësin Hoqa e Qytetit për inçizimin e gjendjes aktuale së bashku me ekipin e mirëmbajtjes (është dhënë raporti për këtë vizitë), 2x;
- *Vizita në objektin e ujësjellësit Zhur ku është bërë riaktivizimi I procesit të klorifikimit (është vënë dozatori për dozimin e klorit) 2x;
- *Furnizimi I rregullt të fshatrave me ujë zhaveli për fshatrat e Hasit: Lubizhdë, Kushnin, Kabash, si dhe Zhur;
- *Riparimi dhe vënja e bravës dhe të zinxhirit në derën e rezervoarit Kala;
- *Përcjellja permanente e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit;
- *Furnizimi I rregullt me Klor të lëngët të fshatrave të Hasit, Lubizhda , Kabash dhe Kushnin;
- *Vizita në Prishtinë në ZRRUK te z.Qamil Musa. Diskutuam rreth çështjes së Monitorimit të Mbrendshëm. JU kemi njoftuar më hollësisht në lidhje me këtë çështje;
- *Pas ankesës së disa konsumatorëve në Lagjen Bajram Curri dhe Arbanë kemi vizituar konsumatorët në fjalë dhe konstatuam se sa I përket kualitetit të ujit çdo gjë ishte në rregull. Prezent ishte edhe Menaxheri Teknik L.Paqarizi;
- *Pas erërave të forta kemi pasur ndërprerje të energjisë elektrike në 40 Burimet si dhe te pompat në ashtuq.”Te Livadhi”.Pasi që furnizimi disi u stabilizua është dashur që të largojmë ujin për shkak të turbiditetit. Veprime të tilla I kemi përsëritur disa herë përderisa u stabilizua gjendja gjegjësiht, deri sa nuk ka figuruar turbiditeti;
- *Shkarkimi I ujërave në 40 Burime me gravitacion për shkak të rreshjeve të mëdha si dhe mungesës së energjisë elektrike(nuk kemi mundur të aktivizojmë pompat). Të nesërmen në mëngjez, pasi që sistemet u stabilizuan, menjëherë, I kemi futur në sistem duke e përcjellur vazhdimisht gjendjen në teren;
- *Me kërkesë të ekipit të kontrollit kemi bërë kontrollin e ujit në fabrikën “Dratex”-Dragash.
- *Dalja me ekipin e kontrollës për verifikimin e keqpqrdorimeve eventuale në lagjen Dardani, pjesa e fundit nga ndëramprrja “Bini”;
- *Pranimi i ngarkesës së klorit, klor gaz 1 t dhe montimi i saj dhe 5 x 150 kg bombola me Cl- gaz;
- *Furnizimi I rregullt të fshatrave të anës Hasit, Kabash, Lubizhdë dhe Kushnin si dhe ujësjellësin Zhur;
- *Me kërkesë të ekipit të kontrollës kemi kontrolluar ujin e pijes në Arbanë, pasi që ka pasur ankesa për kuletet të ujit, I vie era ujit. Është konstatuar se ka përzierje të ujit të pijes me atë të vadës;
- *Ndërrimi I të gjitha bombolave kundër zjarrit në vëndet ku janë rojtarët;
- *Eliminimi I defekteve në kabllo të elektrike në laborator(ndarja e rrjetave sipas fuqisë së aparateve dhe instrumenteve në laborator). Për shkak të ngarkesës siguresat nuk kanë funksionuar në mënyrë të rregullt;
- *Disa ditë nuk ka pasur ujë në rrjetë;
- *Riparimi I pompës për dozim të klorit në Mulli, në O 400;

Analizat Bakteriologjike Tetor - Dhjetor 2015, TM-4, ISHP-Prizren

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	03	01
	Ujësjellës	146	00
Suharekë	Burim	00	00
	Ujësjellës	18	00
Dragash	Burim	00	00
	Ujësjellës	05	00
Malishevë	Burim	00	00
	Ujësjellës	16	00
Totali		188	00

2.7 Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza

Faza e pare I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

- Të dhënat Teknike

-Gjithsejt gjatesia e kolektorit qe do te instalohet eshte rreth 5100m.

- Diametri i kolektorit fillon nga DN500mm deri ne DN1200mm ne hymje te ITUZ-se dhe DN 1000mm ne dalje te ITUZ-se. Tipi i gypit eshte HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m2) dhe Gize K9

- Kolektori do te vendoset ne rruge ne anen e djathte te rrjedhjes se Lumbardhit dhe do te vendoset ne vendin e kolektorit te vjeter, ku do te perfshije keto rruge: Enver Haradinaj, Remzi Ademaj, pjeserisht Wiliam Wolker, Rrugen magjistrale M25 deri tek ITUZ, ndersa vazhdimi i kolektorit nga rrethi i fshatit Hoqe e Qytetit deri tek kyqeja Jugore e Autostrades do te kaloje ne mes te rruges M25 pastaj nga ky pozicion do te vazhdohet deri tek kyqeja ne ITUZ.

Çmimi

-Vlera e punimeve sipas kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU”Hidroregjioni Jugor” Sh.A eshte: 2,043,273.00 Euro.

Afati (data) i fillimit te punimeve

-Sipas planit dinamik te pershkruar ne kontrate punimet duhet te fillojne te Henen me 15.12.2014 dhe duhet te perfundojne te Henen me 12.12.2016, mirpo per shkak te vonesave ne rregullimin e pelqimeve dhe lejeve te cilat jane te domosdoshme per fillimin e punimeve kemi pasur ngecje ne fillimin e realizimit te punimeve ne teren.

-Perfundimisht pas marrjes se te gjitha pelqimeve dhe Lejes nga Drejtoria per Planifikim dhe Urbanizem punimet kane filluar me date 06.06.2015 pasi qe eshte bere furnizimi me material konform kontrates.

Progresi i punimeve ne Faza e pare I te projektit

Ne Pjesen A (Task A) deri me tani jane realizuar hapja e kanalit, vendosja e zhavorit, vendosja e gypave, mbulimi i kanalit te gjitha keto sipas detaleve te dhena ne projekt dhe ate;

Instalimi i Gypave te kolektorit 1265 m.

-Gypi DN800mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m2) L=1215 m,


-Gypi DN1000mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m2) L=1300 m,

Instalimi i pusetave nga P101 deri P151 gjithsej 150 pusetave, si dhe te gjitha pjeset percjellese.

Hoqe e Qytetit, ku ky kaperderdhes eshte ndertuar brenda trupit te rruges M25 dhe njeherit bene lidhjen e kolektorit ekzistues me ate te kolektorit te ri.



rtim
tes s



Punet ndertimore Task A, CSO 1

Obligimet ndaj kontraktorit

Ne baze kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte realizuar edhe pagesa e avansit me vler 20% te kontrates mjete keto te siguruar nga Qeveria e Republikes se Kosoves permes ministris se linjes MMPH.

Sa i perket furnizimit me material nga kontraktori ne si Hidroregjion kemi bere kerkesat e duhura ne MZHE per mundesine e lirimt nga taksat doganore, i kemi derguar ne MZHE te gjitha dokumentet e nevojshme ne lidhje me mundesine e lirimt nga Taksat doganore per pjesen qe do te financohet nga KfW.

Momentalish kane filluar punimet tek CSOS1g te Marashi dhe kolektori te lokacioni i ETC-se

Eshte nenshkruar IPC 1-Fatura e pare per punekryerje te Fazes I nga ana jone dhe eshte derguar tek Passavante, e cila pastaj duhet te dergohet tek KfW pasi qe kjo pagese do te kryhet nga KfW.

Kontigjenti i dyte per Fazen I i furnizimit pas kerkeses sone dhe plotesimit te dokumentacionit perkates ne MZHE, eshte liruar nga TVSH-ja.

Faza e dyte II e projektit:

"Dizajnimi dhe ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujerave te zeza"

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, per realizimin e ketij projekti me date: 05.05.2015 eshte nenshkruar kontrata ne mes te kompanise AQUALIA nga Spanja si dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, vlera e kontrates eshte 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrevshjes kontraktuale per kete porjket duhet te paguhet avanci me vlere prej 20% e vleres se kontrates, pagese te cilen duhet ta paguaj MMPH.

-Deri me tani konform marrevshjes speciale te reviduar nga ana e kontributit vendor jane paguar ne emer te avancit per Fazen II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar ne Marrevshjen e vecant ne te cilen eshte qartesuar planifikimi i mjeteve per kontributin vendor dhe kontributin e jashtem, eshte riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave te takimit te dates 14 Tetor 2015 te nenshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW eshte parapare:

Kontributi vendor

2014	Euro	FAZA I	99,763.70
2015	Euro	Pjesa e pare e vitit FAZA I	374,275.82
2015	Euro	Pjesa e dyte e vitit FAZA II	625,000.00
2016	Euro		2,500,000.00
2017	Euro		1,400,960.48
			=====
			5,000,000.00 EURO

Aktivitetet e ndërtimit Faza 2

Kontraktori ka finalizuar çështjet e mobilizimit dhe ato administrative. Faturat e pagesës së avansit eshte dorëzuar.

Tani kontraktori është duke punuar në projekt,

- përditësimi i trasesë (layout) së Impjantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në bazë të kërkesave të punëdhënësit,
- përgatitja e orarit të projektimit dhe planit dinamik është në progress,
- kordinimi për zhvendosjen e linjës së rrymës elektrike mbitokësore me KEDS-in,
- kordinimi i pikave kyqëse të furnizimit me rrymë për Impjantin për Trajtimin e Ujërave të Zeza me KEDS-in,
- kontraktori do të angazhojë një kompani për të bërë matjet gjeodezike.

Periudha e projektimit është 120 ditë. Për të shmangur vonesat për shkak të dokumenteve jo të kënaqshme të projektit, është pajtuar që të dorëzohen projektet në pako.

Pakoja e parë – Projekti Konceptual i Azhurnuar u dorëzua me 24 Korrik

- Që përbëhet nga një vizatim i trasesë (layout), P&ID, profil hidraulik.

Pakoja e dytë – Projekti Kryesor pritet me datën 30 Shtator

- Vizatimet që kërkohen për marrjen e lejes për projektet e kategorisë III, p.sh. projektet civile për të gjitha strukturat dhe njësitë, të gjitha vizatimet layout (të përgjithshme, gypat, rryma, rrugët, hapësira, etj), vizatimet e azhurnuara të projektit konceptual. Ku kjo pako është prezantuar në takimin e fundit të mbajtur në HRJ në fillim të muajit Nentor 2015

Pakoja e tretë – Projekti i Detajuar pritet të jetë pjesërisht krahas me progresin në ndërtim.

- Vizatimet detale që kërkohen për ndërtimin e secilës njësi/ndërtesë/strukturë, duke përfshirë kalkulimet statilke, lista e paisjeve etj. (krahas progresit të projektit).

-Në takimin e fundit gjatë muajit tetor kemi patur një takim me kontraktorin e Fazës II dhe Konsulencën ku dhe kemi diskutuar në lidhje me shtrirëjen-situacionin e brendshëm të impiantit, që nënkupton metodën e trajtimit, shtrirëjen e objekteve administrative dhe percjellese, dhe pritet miratimi nga ana e HRJ-se.

-Punëdhënësi HRJ ka shprehur gadishmërinë për t'i asistuar Kontraktorit në të gjitha çështjet për të marrë lejet e kërkuara. Ligjet relevante dhe udhëzimet administrative iu janë dhënë Kontraktorit.



Pamja e ITUZ-se ne 3D

-Për shkak të pengesave nga pronarët e shpërndarur nuk ka aktivitete të ndërtimit deri më tani

-Ne se bashku me konsulencen dhe kontaktorin ne nje takimi ne zyren e DSHP-se dhe permes nje shkrese elektronike e kem njoftuar DSHP ne komunen e Prizrenit, per pengeset qe i kemi nga pronaret e shpronësuar te lokacionit ku do te ndertohet ITUZ dhe kemi kerkuar nga DSHP si bartese e projektit per shpronësime qe te ndermarre masat e duhura qe mos te ngecim me projektin ne fjale pasi qe cdo vonese do te reflektoje ne kosoton e projektit si dhe do te rrezikoj investimin ne pergjithesi.

-Pas bisedes telefonike qe kam pas me zyrtarin komunal ne zyren e pronave ne komunen e Prizrenit, z. Gursel Skenderi, me eshte thene se pa u paguar edhe centi i fundit tek [ronaret ne nuk kemi te drejte qe pronat e tyre ti bartim tek Komuna.

-Sa i perket lejes se ndertimit te cilen duhat ta kerkojme tek Departamenti i ndertimit ne MMPH, paraprakisht duhet nxjerre dokumenti i VNM-se , i cili po ashtu kerkon kriterin kryesor shpronësimit perfundimyatre te lokacionit, prandaj ne rast se kemi pengesa ne pagesen e pronarve, komuna e prizrenit duhet te krijoj nje KONTO MIREBESIMI ne te cilen duhet te derdhe te gjitha mjetet e parapare per shpronësime dhe ne momentin qe do ta kemi kete dokkument do te fillohet me perpilimin e VNM-se si kusht kryesor per posedimin e lejes se ndertimit nga MMPH.

Perpos takimeve per mbarevajtje te punimeve nuk kemi patur ndonje progres te theksuar ne lidhje me Projektin ne fjale,

Pas takimit me Drejtorin e sherbimeve publike ne nje konference i njeiti gojarisht me tha qe sa i perket kontos se mirebesimit ajo do te nxjerret nga komuna vitin e ardhshem ne fillim te 2016-tes.

2.8 Raport i Aktiviteteve të Njësive operative

Aktivitetet TM-4, 2015 - Njesia Prizren

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, përveq në disa raste kur ka pasë ndonjë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellësit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujëmatësave.

Prodhimi i ujit: gjatë TM-4 janë prodhuar 3,209,100.00m³ ujë ose 403.7 l/s dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët përveq në lagjet me sistem pompimi Bazhderhanen, Dardanin dhe pjesën e eperme të Tusuzit.

Humbjet e ujit: humbjet e ujit arrijnë në 58.09% për shkak të rrjetit të vjetër të ujësjellësit, dhe ndërhyrjeve të pa legalizuara.

Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe kanalizimit:

Gjatë muajve Tetor-Dhjetor furnizimi me ujë ka qenë i rregullt 24 orë në zonat e ulta dhe me reduktime në lagjet Dardania ,Bazhderhane dhe Tusuz

Gjatë TM-4, janë marr disa hapa konkret lidhur me sanimet kolektive ku në kordinim me Komunitetin, Komunën dhe Hidroregjionin Jugor janë ndërruar gypat e furnizimit në disa rrugica si rruga Mihael Grameno, Rruga Perveza dhe Banesat e Solidariteti.

Rruget të cilat janë perfunduar, gypin e ka furnizuar Komuniteti punet teknike Kompania kurse shtrirjen e rruges me kubza e ka krye komuna.

Ka perfunduar projekti në fazën e parë rehabilitimi i rrjetit në rruget qendrore të qytetit ku ka perfunduar puna në rrugën Halil Berisha.

Nga ana e njësive janë disloku disa kyqje të cilat nuk ishin planifikuar ku në njëren prej rrugicës ka pas gyp të azbestit të cilat kanë qënë të lidhura në gypin e vjetër të azbestit dhe janë lidhur në gypin polietilen si dhe është eliminuar krejtësisht gypi i azbestit i cili ka funksionuar deri tani para lidhjes së Eurocentrit.

Janë marr të gjitha veprimet për sigurimin e lejes për fillimin e punimeve në sheshin Shatervan ku janë siguruar të gjitha lejet përveq nga drejtoria e kultures ku me iniciimin e drejtorisë së kultures është formuar komisioni dhe në ditët e ardhshme presim me dal në vendëngjarje dhe me marr lejen perkatëse nga ministria e kultures.

Në kordinim me kuvendin Komunal dhe komunitetin dhe pas hartimit të projektit per lagjen Desave janë duke u zhvilluar punimet ku investim i pergjithshem do të jetë **34015** euro

Gjatë TM-4, pas aksidentit me zjarr njesia e Prizren-it ka bere pastrimin e mbeturinave dhe ka bere instalimin e rrymes.

Aktivite mujore jane paraqit ne menyre tabelare per secilen dite ku jane paraqitur datat lokacioni dhe profili.

Gjat TM-4, janë shqyrtuar gjithesejt **624** ankesa dhe te gjitha kan perfunduar me eliminimin e defekteve te ndryshme

Në rrjetin e ujësjellsit janë bërë **426**.aktivite ,ndërsa në rrjetin e kanalizimit **198**.raste

Gjithësejt aktivite në Ujësjellës TM4																	426			
1	Lloji I gypit apo profili	Ø 1 / 2	Ø 3 / 4	Ø 5 / 1	Ø 6 / 4	Ø 8 / 2	Ø 10 / 0	Ø 12 / 3	Ø 15 / 0	Ø 20 / 0	Ø 25 / 0	Ø 30 / 0	Ø 40 / 0	Ø 50 / 0	Ø 60 / 0	C i s t e r n a	K o m p r e s o r	R e g u l i m i		
2	Defektet ne baz te profilin te gypit	20	76	71	32	8	34	2	11	10	18	15	5	2	2	0	0	4	34	24
3	Defektet ne rrjetin Sekondar	264																		
4	Defektet ne rrjetin primar	42																		
5	Defektet ne komplet rrjetin	306																		
6	Bartja e ujit me Cistern	32 m3																		
7	Pastrimi dhe fryrja me kompresor	34																		

Gjithësejt aktivite në Kanalizim TM 4		161
1	Kontroll pusetes	360 copa
2	Pastrimi pusetes	178 copa
3	Kontroll Kanaliz.	7115 metra
4	Pastrimi kanaliz.	3986 metra
5	Ndërrimi pusetes	0 copa
6	Ndërrimi kanaliz.	13 metra
7	Riparimi Rrugës	158 met. Katror

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjenik Regjional janë në bazë të raporteve mujore

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).

- Marja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- Marrja e mostrave **Fiziko-Kimike**
- Marrja e mostrave **Bakteriologjike**

Aktivitetet TM-4, 20105 - Njesia Suharekë

*Furnizimi me ujë TM-4-2015, ka qene i rregullt gjate kesaj perjudhe tremujore dhe pa ndërprerje, në përjashtim të ndërprerjes së energjisë elektrike të Pusi i Atit (Malsi e Re), pasi që KEDS-i ka bërë disa ndërtime të shtyllave si dhe montimin e një stabilimenti për efqiencë të energjisë në stacionin e pompave (në trafo kryesore).

*Analizat e ujit - gjatë TM-4/2015, janë realizuar 10 (të paktën janë paraqitur tek njësia jonë) mostra të analizave bakteriologjike dhe 10 mostra i ‘u kanë përgjigje standardeve sipas Institutit të Shëndetit Publik.

*Rregullimi i defekteve - në TM-4/2015, është intervenuar dhe atë 58 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale, 15 deblokime të kanalizim.

*Kyqje në rrjetin e ri të ujësjellësit në fshatrat:

-Doberdelan - në bashkëpunim me banorët e fshatit, është bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit \varnothing 50 mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” ndërsa furnizimi me gyp dhe pjesë fazonike janë të financuar nga banorët, deri më tani, janë realizuar 4 lidhje të reja.

-Studenqan – në bashkëpunim me banorët e fshatit, është bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit \varnothing 50 mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor ” ndërsa furnizimi me gyp dhe pjesë fazonike janë të financuar nga banorët, deri më tani, janë realizuar 6 lidhje të reja.

-Mushtishtë, janë bërë 9 lidhje të reja, punët e gërmimit janë kryer nga kompania e cila ka bërë rregullimin e rrugës(vendosjen e kabëzave), si dhe montimin e pusetave jashtë oborreve të konsumatorëve. Lidhjet janë bërë në gypin e ri nga PE me diametër \varnothing 90 mm, ndërsa pjesët fazonike dhe ujëmatësit janë të furnizuar nga depo e ujësjellësit.

*Montimi i Ujëmatësave - në fshatin Mushtisht, janë vendosur 8 ujëmatësa të rinjë, të kyqjëve individuale (diametër $\frac{3}{4}$).

* Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në Qendrën Zejtare II - gjatë TM-4 është bërë ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Qendrën Zejtare II, me investime nga Komuna e Suharekës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërsa vendosjen dhe lidhjen e rrjetit e ka bërë kompania jonë. Me këtë projekt është përmirësuar dukshëm furnizimi me ujë dhe janë zvogëluar humbjet teknike, është krijuar një presion optimal tek konsumatorët.

Aktivitetet TM-4, 2015 – Njesia Malishevë

*Furnizimi me ujë gjatë TM-4/2015, ka qenë i mirë dhe pa reduktime.

*Analizat e ujit – gjatë TM-4/2015, janë realizuar 15 (të paktën janë paraqitur tek njësia jonë) mostra të analizave bakteriologjike dhe 15 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

*Aktivitete lobimi - Kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit, si dhe me Drejtorin e Financave.

*Takim me perfaqësuesit e kompanis N.N.QENDRIMI, per projektin Rinovimi i Kanalizimeve ne fshatrat e K.Malisheve, ku janë duke vazhduar punimet në këtë projekt.

*Takim me përfaqësuesit e kompanis N.N.BELI, për projektin Ndertimi i Galerive ujëmbledhëse në fshatin Senik, ku sipas kërkesës që është bërë nga ana e kompanisë, është bërë ndërprerja e punimëve për shkaqe të pengesave gjatë ekzekutimit nga pala e tret.

*Takim me perfaqësuesit e kompanis N.N.SH.BURIMI'', ku është bërë kërkesa nga ana e kompanisë në fjal për formimin e komisionit për pranimin teknik në projektin Hapja e puseve pizometër si dhe eksplotuse në fshatrat e K.Malisheve.

**Rregullimi i defekteve - TM-4/2015.*

Rrjeti primar 62 defekte, rrjeti sekondar 87 defekte, deblokimi i kanalizimeve 56 ndërhyrje dhe 7.10 km kanal të pastruar, ankesat teknike 11, ankesat komerciale 16, kontrata te lidhura 85, njoftime për shkyqje 458, shkyqje për mos pagesë 5, kyqje ilegale 4, shkyqje të kyqjeve ilegale 1, rikyqje 4, kyqje të reja 23, amvisëri 23, nr.i bllombave 372, procesverbale të shkyqjeve 8, verifikim të ujëmatësave 574, ujëmatësa të ndërruar 11, ujëmatësa të montuar 9.

Aktivitetet TM-4, 2015 - Njesia Dragash

**Furnizimi me ujë - gjatë TM-4*, ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundsuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këti muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusëve dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh, është pastruar edhe kaugulatori.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi,kaugulimi,filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

**Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto:* 5 kyqje në ujësjellës, 24 pastrim i pusëve se kanalizimit, 610m deblokim dhe pastrim ne rrjetin e kanalizimit, 17 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 12 ndrrime të ujëmatësave, 2 montime të ujëmatësave të ri, 28 pastrim dhe kontrole të ujëmatësave, 18 angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshire punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratë së përgjithëshme.

*Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimit në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.

**Prodhimi i ujit: gjatë TM-4* janë prodhuar 65,130.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

**Humbjet e ujit: humbjet e ujit gjatë TM-4* arrijnë deri në 50.9 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

ARSYESHMERI E PERFORMANCAVE TE ARRITURA

*Në kompanin e „Hidroregjioni Jugor“ shërbimi teknik ka arritur të realizon synimet në furnizimin të rregullt me ujë, eliminimin e defekteve me kohë etj.

PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

*Humbjete ujit dhe vazhdimsia e keqepërdorimi i ujit nga ana e qytetarëve.

*Numri i madhë i defektëve në sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit .

*Numri i rrjedhjeve në objektete e pa banuar, ku ekipa e detektimit është në bashkpunim me operativen janë duke vazhduar për të gjetur rrjedhjet e ujit.

MASAT E REALIZUARA NGA MUAJT PARAPRAK

*Ne kompanin tonë gjatë TM-4/2015, ka vazhduar të ketë keqpërdorime të ujit nga ana e konsumatorëve, mirëpo kemi ulje te vleres së UPF-së, në **57.89 %**, me zvoglim **0.07%**, nga muajt paraprak.

*Riparimi i defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, ku janë realizuar gjithësej 781 raste, në rrjetin ujësjellësit 530 defekte dhe në rrjetin kanalizimit 251 raste.

*Pastrimi i 17,700 m në rrjetin e kanalizimit.

*Riparimi i rrugëve 158 m²

*Furnizimi me uje ka qenë i rregullët në të gjitha njesitë.

*Detektimi i rrjetit të ujësjellësit me gjatësi 2,449 m dhe gjetjen e 85 defekteve, nga gjithësej 132 detekttime.

MASAT E PROPOZUARA PER MUAJIN E ARDISHËM

*Gjetjen e lidhjeve ilegale.

*Ulja e vlerave te UPF-së.

*Angazhimet shtesë të ekipes së kontrollës.

*Detektimit i rrjetit për të gjetur dhe eliminuar sa më shpejtë të defekteve.

*Vetëdisimi i qytetarëve për shfrytëzimin e drejtë të ujit të pijes.

*Bashkëpunimi me institucionet – Kuvendin Komunal etj.

*Bashkëpunimi në realizimin e projekteve nga donatorët.

III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.1 Aktivitetet

- Në fund të TM4 2015 në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 42,755 fatura, prej tyre: 37,073 amvisëri , 5,075 biznese dhe 607 institucione. Në TM4 në krahasim TM3 kemi 366 fatura të lëshuara me tepër.

TM3- 2015

Konsumatorët e Regjistruar	numër	42,387
Konsumatorët Shtëpiak	numër	36,717
Konsumatorët Komercial-Industrial	numër	5,064
Konsumatorët Institucional	numër	606

TM4- 2015

Konsumatorët e Regjistruar	numër	42,755
Konsumatorët Shtëpiak	numër	37,073
Konsumatorët Komercial-Industrial	numër	5,075
Konsumatorët Institucional	numër	607

- Gjatë TM4 janë faturuar **1,713,782** m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: **1,432,435** m³, biznese: **115,447** m³ dhe institucione **165,900** m³ ujë. Nëse e krahasojmë me TM3 kemi një faturim më të vogël prej 392,870 m³. Ulje e sasisë së faturimit në krahasim me TM3 ka ndodh te amvisërit , bizneset dhe institucionet : (te amvisëria – 352,858 m³, te bizneset prej – 39,809 m³ dhe institucionet -203 m³). Arsye kryesore për ulje e sasisë së faturuar në m³ të ujit është zvoglimi i konsumit sezonal të ujit.

TM3- 2015

Uji i Faturuar	m3	2,106,652
Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,785,293
Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	155,256
Konsumatorët Institucional	m3	166,103

TM4- 2015

Uji i Faturuar	m3	1,713,782
Konsumatorët Shtëpiak	m3	1,432,435
Konsumatorët Komercial-Industrial	m3	115,447
Konsumatorët Institucional	m3	165,900

- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a. Gjatë TM4 në nivel rajonal nga ekipet e kontrollës janë vizitu 3545 konsumatorë, janë regjistru 526 konsumatorë të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar konsumatorët ilegal.

3.2 RAPORT I EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES – TM3- TM4- 2015

TM3-2015

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Kyçje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi
Prizren	100	0	0	398	0.00
Suharekë	71	4	8	387	9,865.78
Malishevë	48	3	16	622	10,844.93
Dragash	0	0	0	0	0.00
KRU "Hidroregjioni Jugor"	219	7	24	1407	20,710.71 €

TM3-2015

Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Kyçje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	
Prizren	276	0	0	1266	
Suharekë	96	13	9	1271	
Malishevë	154	8	17	1008	
Dragash	0	0	0	0	
KRU "Hidroregjioni Jugor"	526	21	26	3545	

- Gjate TM4 në nivel rajonal janë pranuar 195 ankesa në total, prej tyre 149 ankesa teknike dhe 46 ankesa komerciale. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në pajtim me procedurat e mbrendshme të Kompanisë, të ankesat komerciale konsumatorët kanë marr përgjigje me shkrim nga komisioni i cili ka shqyrtuar këto ankesa.

TM3- 2015

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	244
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	244
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	100
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	100
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	100
TOTAL		344

TM4- 2015

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	268
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	268
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	174
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	174
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	174
TOTAL		442

3.3 PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

- Rënië në faturim si rezultat i uljes së konsumit sezonal.
- Numër i vogël i konsumatorëve që i drejtohen zyrës së Shërbimit me konsumator për aplikim për falje të borxheve deri ne dhjetor 2008 dhe njëkohësisht pagesën e borxheve pas vitit 2008.
- Gjendja e rënde ekonomike e një numri të konsiderueshëm e konsumatorëve, Shërbimi me Konsumatorë në secilën njësi është duke i evidentuar rastet të cilët janë nën përkujdesje sociale dhe pastaj ti drejtoheni Qeverisë apo Ministrive përkatëse lidhur me pagesën e këtyre obligimeve. Është shqetësues numri i konsumatorëve që viziton zyret e shërbimit me konsumatorë në secilën njësi e të cilët ankohen në pamundësi të pagesës së obligimeve të ujësjellësit.
- Ekipet e kontrollës nuk po kanë mundësi në shkyqje te konsumatorëve pasi më tepër po bëjnë presion te konsumatorët që ata të bëjnë kërkesë për falje të borxheve dhe pagesën e pjesës tjetër pas vitit 2008.
- Borxhet e trashëguara si rezultat i ndarjes së trashëgimisë (nga babai te vëllezrit), shitblerjet e pronave të cilat kanë trashëgu borxhe, pronat e shfrytëzuara në mnëyrë të paligjshme etj.

3.4 MASAT E REALIZUARA/ MOSREALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Janë shpërnda njoftime per mospagesë te një teren i inkasantëve, dhe janë vizituar nga ekipet e kontrollës për mospagesën e borxheve ku është kërku nga ta që të bëjnë kërkesë për falje dhe pagesën pas vitit 2008 ose riprogramim të borxheve.
- Rritje në numrin e konsumatorëve në zonën e shërbimit për 526 konsumatorë.
- Janë vizituar 3545 konsumatorë tek të cilët është bërë vizit rutinore për lexim të ujëmatësve, keqpërdorime eventuale të ujit apo edhe kontrole tjera.
- Ka vazhdu shqyrtimi i kerkesave te konsumatoreve per faljen e borxhit dhe ne vazhdim gjeni raportin:

3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN E ARDHSHME

- Vazhdimësia e shpërndarja e njoftimeve për mospagesë te të gjithë konsumatorët , dhe njoftimin e tyre tek secili konsumatorë për mundësin e faljes së borxheve.
- Njoftime të rregullta në media dhe apel për pagesën e obligimeve në media elektronike dhe të shkruara.
- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit. Për secilin muaj në muajt në vijim do të shpërndahen njoftime për mospagesë.
- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shuma të larta të borgjëve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borgjeve në menyrë që këta konsumatorë të futen në sistem të pagesave të fakturave. Secili inkasant në teren mund të bëjë kontrata për riprogramim te konsumatorët e terrenit të tij, te ata konsumatorë që kanë borxh mbi 200 euro.
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pages nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borgjit total .Te këto raste nuk do të bëhet rikyqja pa u bërë një pjesë e pagesës dhe të nënshkruhet kontrata për riprogramim të borxheve.

- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkyqjen e konsumatorve për mos pages. Secili konsumatorë para shkyqjes duhet të njoftohet bazuar në procedurat ligjore nga Zyra Rregullative.
- Rritja e efikasitet të ekipes së kontrollës dhe ekipës së shkyqjes.
- Inicimi i padive të konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë. Tek rastet ku nuk ka mundësi teknike të shkyqjes ato raste do të inicohen në gjykatë për zgjidhjen e problemit të borxhit.

Falja e borxheve

Periudha:12/10/2015 - 11/01/2016

Njesia	Nr. i Kons.	Nr. Kontratave per falje te borxheve	Shuma e kontraktuar	Shuma e inkasuar	Shuma e Falur
Prizreni	1118	1100	29,938.86	128,029.98	246,063.90
Suhareka	86	85	14,259.33	6,125.68	16,007.02
Malisheva	90	90	15,589.55	5,909.92	11,814.95
Dragashi	122	127	7,185.21	7,725.51	31,416.57
total	1416	1402	66,972.95	147,791.09	305,302.44

3.6 Raport i medieve

TETOR – 2015

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	02.10.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË PËR SHKAK TË PUNIMEVE
2	02.10.2015	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: HIDROREGJIONI JUGOR NJOFTON SE NGA DATA 6 DERI MË 20 TETOR,DISA LAGJE TË PRIZRENIT DO TË KENË REDUKTIME TË UJIT
3	02.10.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: KONSUMATORËT E PRIZRENIT QË DO TË MBESIN PA UJË
4	02.10.2015	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: KONSUMATORËT E PRIZRENIT QË DO TË MBESIN PA UJË
5	02.10.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: NDËRROHEN GYPAT, DY JAVË BANORËT E 6 RRUGËVE NË PRIZREN,NUK DO TË FURNIZOHEN RREGULLISHT ME UJË
6	05.10.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË REGJIONIN E HASIT,PËR SHKAK TË INTERVENIMEVE TË KEDS-IT NË RRJETIN DISTRIBUTIV
7	08.10.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË INTERVENIMEVE TË KEDS-IT NË RRJETIN DISTRIBUTIV

8	09.10.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË FSHATRAT: ZHUR, VËRMICË, SHKOZË DHE DOBRUSHT, PËR SHKAK TË INTERVENIMEVE TË KEDS-IT NË RRJETIN DISTRIBUTIV
9	20.10.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	PRONONCIM LIDHUR ME FALJEN E BORXHEVE
10	20.10.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: KRU "HIDROREGJIONI JUGOR"- FTON KONSUMATORËT BORXHLINJË TË BËJNË KËRKESA PËR FALJE TË BORXHIT DERI NË VITIN 2008
11	20.10.2015	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR" FTON BORXHLINJTË TË BËJNË KËRKESË PËR FALJE TË BORXHIT
12	20.10.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR" FAL BORXHET E KALUARA DERI NË 2008 -tën
13	28.10.2015	TV-OPINION	EMISION I MËNGJESIT-FALJA E BORXHEVE TË KONSUMATORËVE DERI NË VITIN 2008
14	28.10.2015	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: NDËRTIMI I IMPIANTIT TË UJËRAVE TË ZEZA

NËNTOT - 2015

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	19.11.2015	TV-OPINION	EMISION I MËNGJESIT - FALJA E BORXHEVE TË KONSUMATORËVE
2	21.11.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: FALJA E BORXHEVE TË KONSUMATORËVE
3	22.11.2015	TV-OPINION	NJOFTIM: ZVOGËLIM I SASISË SË UJIT, PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
4	22.11.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: ZVOGËLIM I SASISË SË UJIT, PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
5	23.11.2015	TV-OPINION	PRONONCIM LIDHUR ME ZJARRIN E SHKAKTUAR NË KOMPANI
6	23.11.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: DIGJET ZYRA E INKASANTËVE NË KRU-"HIDROREGJIONI JUGOR"- PRIZREN
7	23.11.2015	www.tv-opinion.facebook	ARTIKULLI: DIGJET ZYRA E INKASANTËVE NË KRU-"HIDROREGJIONI JUGOR"- PRIZREN
8	24.11.2015	www.tv-opinion.com	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË DEFECTIT
9	26.11.2015	KOHA DITORE	ARTIKULLI: BIE ZJARR NË KOMPANINË "HIDROREGJIONI JUGOR"
10	26.11.2015	www.koha.net	ARTIKULLI: BIE ZJARR NË KOMPANINË "HIDROREGJIONI JUGOR"

11	30.11.2015	TV-OPINION	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË LAGJEN "ORTAKOLL", PËR SHKAK TË PUNIMEVE
12	30.11.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: REDUKTIME TË UJIT PËR SHKAK TË PUNIMEVE
13	30.11.2015	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: PËR SHKAK TË NDËRRIMIT TË GYPIT KRYESOR, DO TË KETË REDUKTIME TË UJIT NË DISA LAGJE TË QYTETIT
14	30.11.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: REDUKTIME TË UJIT NË QYTETIN E PRIZRENIT
15	30.11.2015	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: JA CILAT PJESË TË QYTETIT TË PRIZRENIT NUK DO TË KENË UJË

DHJETOR – 2015

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	08.12.2015	TV - BESA TV- PRIZRENI TV- OPINION	VIZITA E ZËVENDËSMINISTRIT SHALA NË KRU-" HIDROREGJIONI JUGOR"-PRIZREN
2	08.12.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: SA MË PARË TË BËHET SHPRONËSIMI I PRONAVE KU DO TË NDËRTOHET IMPIANTI I UJËRAVE TË ZEZA, THONË PËRFAQËSUESIT E MINISTRISË SË FINANCAVE
3	08.12.2015	www.botasot.info	ARTIKULLI: ZËVENDËSMINISTRI SHALA VIZITOI UJËSJELLËSIN REGIONAL TË PRIZRENIT
4	08.12.2015	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: ZËVENDËSMINISTRI I MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR FERAT SHALA, SOT E VIZITOI KOMPANINË E HIDROREGJIONIT JUGOR
5	08.12.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: ZËVENDËSMINISTRI I MJEDISIT, FERAT SHALA, TAKOI DREJTUESIT E KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" NË PRIZREN
6	08.12.2015	TV-OPINION	ZV/MINISTRI SHALA TAKOHET ME DREJTUSIT E HIDROREGJIONIT JUGOR

7	08.12.2015	www.ekonomiaonline.com	ARTIKULLI: PRIZRENI, SË SHPEJTI ME IMPIANT PËR UJËRAT E ZEZA
8	10.12.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: MË NË FUND,FAL ANGAZHIMIT EDHE TË "EC MA NDRYSHE", ZGJIDHET PROBLEMI I UJIT NË BAZHDARHANE
9	11.12.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA , PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
10	11.12.2015	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: REDUKTIME TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATRA ZHUR, VËRMICË, SHKOZË DHE DOBRUSHT
11	11.12.2015	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR" NJOFTON, SE NË MUNGESË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DO TË KETË REDUKTIME TË UJIT TË PIJES
12	11.12.2015	TELEVIZIONI OPINION	ARTIKULLI: LAGJJA BAZHDARHANE NË PRIZREN, ZGJEDH PROBLEMIN E UJIT
13	11.12.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: ZHURI, VËRMICA,SHKOZA DHE DOBRUSHTI, NESËR 4 ORË NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
14	11.12.2015	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: JA CILAT FSHATRA TË PRIZRENIT, NESËR NUK DO TË KENË UJË
15	11.12.2015	TELEVIZIONI OPINION	ARTIKULLI: REDUKTIME TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATRA ZHUR, VËRMICË, SHKOZË DHE DOBRUSHT
16	18.12.2015	TV-OPINION,TV-PRIZRENI ,TV-BESA	PËRURIMI I 4 PUSEVE TË REJA, NË AFËRSI TË VENDIT "40 BURIMET"
17	18.12.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: VIHEN NË FUNKSION EDHE 4 PUSE TË REJA ME RRETH 100 l/s PËR FURNIZIM NORMAL ME UJË NË KOMUNËN E PRIZRENIT
18	18.12.2015	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: KOMUNA E PRIZRENIT INVESTON 1 MILION EURO PËR UJË TË PIJES

19	21.12.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS , PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGIJË ELEKTRIKE
20	21.12.2015	TELEVIZIONI PRIZRENIT	SHKAKU I PUNIMEVE NGA KEDS, NESËR REDUKTIME TË UJIT NË TRE FSHATRA TË SUHAREKËS
21	22.12.2015	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS , PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGIJË ELEKTRIKE
22	22.12.2015	www.rtvbesafacebook.com	ARTIKULLI: NDËRPRERJA E ENERGIJË ELEKTRIKE, LË PA UJË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS
23	24.12.2015	KOHA DITORE	ARTIKULLI: REZERVUARI I UJIT CENON STRUKTURËN E KALASË SË PRIZRENIT

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

4.1.1 Aktivitetet TM4- 2015

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e Raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, Komiteti i Financave, Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Staf dhe Shpërblime dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim gjatë kësaj periudhe kohore ka lëshur për të punësuarit të gjitha llojet e Aktvendimeve, Autorizimeve dhe Vërtetimeve nga fusha e marëdhënieve të punës.
- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 , për punonjësit është bërë kompenzimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi.
- Edhe në këtë tremujor janë lëshuar kontrata në kohë të caktuar për praktikant në punë praktike ashtu siq është e paraparë në Planë Biznes të Kompanisë.
- Janë përgaditur Vendime për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik te punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave, dhe të njesive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Në nivel rajonal të Kompanisë në tremujorin e katërt ka pasur **8 (tetë) konkurse**.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit dhe Prishtinës në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të Projekteve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimet përkatëse.

- Gjithashtu nxënësit e Shkollës së Mesme Administrative kanë mbajtur dhe vazhdojnë të mbajnë orë praktike lidhur me punën e Administratës së Kompanisë.
- Sipas kërkesave të derguara janë marrë dy punëtore me Kontrate për punë dhe detyra specifike
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Me datë 08.10.2015 është pensionuar një (1) punëtorë (HE) Kujdestar- Rojtar në Rezervoari i Shpatit i Njesis Punuese Prizren.
- Me datë 09.10.2015i është ndërprerë mardhënja e punës Punëtorit Isen Ramanaj - Kontrollor-shkqyçje i Njesis Punuese Prizren.
- Gjate muaji Tetor janë shpallur pesë (5) Konkurse.
- Janë bërë edhe punë tjera sipas kërkesave të U.D Sekretarit të Kompanisë.
- Sipas kërkesave të derguara janë marrë dy punëtore me Kontrate për punë dhe detyra specifike
- Me 01.11.2015 me vetedëshirë ka bërë shkeputje të kontratës të njëanshme nga një punonjëse (SGJ) - Zyrtare Ligjore për Marrëdhënie me Konsumatorë.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Ka pas ngritje të koeficientit për punëtorin N.K nga 4 në 5.
- Punëtorja Sahadete Kasolli ka sjellë diplomën e bachelore.
- Me datë 16.11.2015 janë dhënë si kompensim 300 euro për vdekjen e bashkshortes së punëtorit (KK) – Inkasant.
- Ka pas pushime vjetore si kompensim për punën jashtë orarit për dy punëtore.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Sipas Rojterit të Objektivit të Drejtorisë në Oratkoll me datë 23.11.2015, aty nga ora 03.40 minuta ka shpërthyer zjarr në aneksin e objektit me ç'rast janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në objektin në fjalë.
- E kemi njoftuar NJPMNP e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë për rastin e Zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 23.11.2015 është bërë largim i perkohshëm për dy punëtore – Rojtar në objektin Ortakoll – (RB) dhe (MK).
- Punëtorin (RB) me datë 17.12.2015 është kthyer në punë pas Konstatimit të Komisionit Disiplinorë të Kompanisë se (RB) nuk ka bërë shkelje të detyrave të punës, andaj i njëjti vazhdon punën si punëtor i rregullt.
- Punëtorin (MK) ende nuk është kthyer në marrëdhënie pune pasi që jemi në pritje të hetimeve nga Krimet e Rënda dhe Prokuroria e Shtetit.
- Me 11.11.2015 i nderpritet kontrata për punë specifike të punëtorit të Njesisë së Malishevës (MM) me pozitë të punës Inkasant.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Sipas kërkesave të derguara janë marrë tre punëtore me Kontrate për punë dhe detyra specifike.
- Gjate muajit Dhjetorë janë shpallur tre (3) Konkurse.
- Me kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv drejtuar Menaxherëve të Sektoreve që gjatë Dhjetorit të dorëzohen vlerësimet e bëra të punëtorëve, kemi filluar me kontratat e punëtorëve për vitin 2016.
- Përgaditja e dokumenteve të nevojshme për aplikim të vazhdimin të licencës së Kompanisë në ZRRUK.

4.1.2 PERSONELI – TETORE– DHJETORE 2015

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Tetor	302	1	1	1	6
Nentor	303	1	1		2
Dhjetor	305	2	/	/	1

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR – 2015

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	254	35	5	11	305
Numri i Punëtorëve në %	83.3 %	11.5 %	1.6 %	3.6 %	100 %

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	34	11.15 %	
MESHKUJ:	271	88.85 %	
TOTAL	305	100 %	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2015

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punëtorëve	31	28	0	192	1	48	5	305
Kualifikimi në %	10.16 %	9.18 %	0.00 %	62.95 %	0.33 %	15.74 %	1.64 %	100 %

4.1.3 RAPORTI I PUNËVE TE KRYERA NË GJYKATA TETOR – DHJETOR 2015

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Kallëzime Penale	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruara nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruara nga	Përgjigje në Ankesat e Parashtrura në Gjykatën e Apelit nga Konsumatorët	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
Tetor 2015	1	1	/	/	1	2	/	/	/	/	5	80
Nëntor 2015	/	/	/	/	4	2	1	/	/	/	7	2
Dhjetor 2015	/	/	/	/	3	1	/	/	/	/	4	12
Totali	1	1	/	/	8	5	1	/	/	/	16	94

PARASHTRESA

- Me datë 12.10.2015, punonjësit (HG) ja kemi drejtuar një Njoftim me të cilin i kërkojmë që të vjen në objektet e KRU-së dhe ta nënshkruaj Marrëveshje për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj kompanisë.
- Me datë 12.10.2015 është nënshkruar marrëveshje për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj Kompanisë nga punëtori (IR) .
- Me datë 12.10.2015, i kemi dhënë Përgjigje në Kërkesën e ish punonjësit (GjR) lidhur me kompensimin e pagave shtesë pas pensionimit të tij.
- Me datë 01.12.2015, e kemi shkruar një Njoftim sipas Kërkesës së MZHE-së, respektivisht NJPM në Prishtinë lidhur me rastin e shpërthimit të zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 07.12.2015, e kemi shkruar një Njoftim për Zëvendës Kryeshefin e Kompanisë (RU) lidhur me Vendimin e marrë nga Bordi i Drejtorëve lidhur me Kërkesën e të njëjtit për vazhdimin e Kontratës së Punës së tij.

VENDIME TË NXJERRA NGA KOMPANIA

- Me datë 09.10.2015, për punonjësin (IR) është nxjerrë Vendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.
- Me datë 24.11.2015, për punonjësin (MK) është përpiluar Vendim për Suspendim të përkohshëm nga puna si pasojë e shpërthimit të zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 24.11.2015, për punonjësin (RB) është përpiluar Vendim për Suspendim të përkohshëm nga puna si pasojë e shpërthimit të zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 24.11.2015, për punonjësin (MK) është përpiluar Aktvendim për iniciimin e Procedurës Disiplinore si pasojë e shpërthimit të zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 24.11.2015, për punonjësin (RB) është përpiluar Aktvendim për iniciimin e Procedurës Disiplinore si pasojë e shpërthimit të zjarrit në Objektin e Drejtorisë së Kompanisë.
- Me datë 25.11.2015, është përpiluar Vendim për caktimin e (KA) anëtarë të Komisionit për shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave të parashtruara nga konsumatorët.

7. Me datë 07.12.2015, është përpiluar një Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e punëve të kryera deri më tani në projektin e F. Senik të Malishevës.
8. Me date 14.12.2015, është marrë Vendim për ndërrimin e vendit të punës për ish Zv. KE-në (RU), ku tani e tutje i njëjti do të kryej punë dhe detyra të punës Zyrtar për Siguri dhe Shëndetin në Punë.
9. Me date 17.12.2015, është nxjerrë Vendim për kthimin në punë të punëtorit (RB) Rojtarë, të suspenduar për shkak të rënjes së zjarrit në Objektivin e Drejtorisë.
10. Me datë 12.12.2015, është nxjerrë Vendim për Malishevë për të verifikuar Aneks Kontratën me firmën nga Xërxa lidhur me materialet e magazinuara në Depon Qendrore të Kompanisë dhe përmbajtjes së Aneks Kontratës.
11. Me datë 23.12.2015, është nxjerrë Vendim me të cilin (KA) sistemohet me punë dhe detyra të punës nga Zyrtar për Siguri dhe Shëndetin në Punë në Zyrtar Ligjor për Marrëdhënie me Konsumatorë.

PADI TË USHTRUARA KUNDËR KOMPANISË

1. Me datë 14.10.2015, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Padi C.nr. 1041/15, datë 13.10.2015 kundër Kompanisë me të cilën Paditësi Posta dhe Telekom i Kosovës, Sh. A. në Prishtinë kërkon Kompensimin e dëmit në vlerë prej 1.744.48 €.
2. Me datë 15.12.2015, nga Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti për Qështje Ekonomike është sjellë- Padi, C.nr. 285/15, datë 18.11.2015 nga K.R.U. “Radoniqi” SH.A. në Gjakovë, me të cilën kërkohet përmbushja e detyrimeve kontraktuese në emër të Qirasë së Objektivit të kësaj Kompanie për shumën monetare në vlerë prej 42.666.00 €. (Është arritur Marrëveshje që pagesat të bëhen në të ardhmen).

PËRGJIGJE NË PADI

1. Me datë 28.08.2015, është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Prizrenit përgjigje në Padi kundër Padi së ngritur nga Paditësi Posta dhe Telekom i Kosovës, Sh. A. në Prishtinë për Kompensimin e dëmit në vlerë prej 1.744.48 €.

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

1. Me datë 09.10.2015, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim Ac.nr. 3840/2013, datë 25.09.2015, sipas të cilit refuzohet tërësisht si e pabazuar Ankesa e Paditësit (SHG), Rr. Selajdin Berisha, nr. 36/b nga Prizreni, lidhur me borxhin në lartësi prej 800 €, dhe Vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 687/2011 të datës 30.07.2013.
2. Me datë 09.10.2015, është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim Ac.nr. 3840/2013, datë 25.09.2015, sipas të cilit Refuzohet tërësisht si e pabazuar Ankesa e Paditësit (SHG), Rr. Selajdin Berisha, nr. 36/b nga Prizreni, lidhur me borxhin në lartësi prej 800 €, dhe Vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 687/2011 të datës 30.07.2013.
3. Me datë 26.11.2015, nga Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, është sjellë- Aktgjykim P. nr. 348/12, datë 28.10.2015, me të cilin shpallen fajtor dhe dënohen me burg në kohëzgjatje prej 13 Muajve dy të akuzuarit: 1) (SK), i lindur në F. Banjë, dhe 2) (LT), i lindur në F. Banjë. Aktgjykimin është sjellë me datë 30.11.2015 nga Udhëheqësi i Nj.P. të Malishevës.
4. Me datë 31.12.2015, nga Gjykata e Apelit e Kosovës është sjellë- Aktvendim Ac.nr. 3530/2014, datë 30.11.2015, sipas të cilit refuzohet si e pabazuar Ankesa e Kreditorit (NA) nga F.Zhur i Prizrenit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prizrenit CP.nr. 803/2014, i dates 20.08.2014 vërtetohet.

VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË

1. Me datë 13.10.2015, është sjellë nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë Aktvendim Ac.nr. 2010/2013, datë 23.09.2015, sipas të cilit aprovohet Ankesa e Paditësit Posta dhe Telekom i Kosovës, Sh. A. në Prishtinë e datës 29.05.2013 për Kompensimin e dëmit në vlerë prej 1.744.48 €, dhe prishet Aktvendimi i

Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 596/2009 i datës 16.05.2013 dhe Lënda i kthehet të njëjtës Gjykatë në rivendosje.

2. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 492/2005, datë 05.08.2005, (AH), Rr. Kadri Nesho, pn. Prizren (302.17 – 25.00).
3. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 520/2005, datë 05.08.2005, (HP), Rr. Gjirokastra, nr. 1. Në Prizren (494.45 – 25.00).
4. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 528/2005, datë 05.08.2005, (SHK), Rr. Mbreti Bardhyl, nr. 24, në Prizren (338.19 – 25.00).
5. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 558/2005, datë 05.08.2005, (IK), Rr. Bingeni nr. E-2/2, në Prizren (241.52 – 12.50).
6. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 634/2005, të datës 05.09.2005, (FB), Rr. Fahredin Hoti, nr 21, në Prizren (706.05 – 37.50).
7. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 676/2005, 05.09.2005, (ShG), Rr. Salajdin Berisha, nr. 36/B, në Prizren (228.80 – 12.50).
8. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 88/2006, datë 20.02.2006, (IV), F. Nashec, Prizren (495.13 – 25.00).
9. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 90/2006, date 20.02.2006, (TG), F.Atmaxhë, Prizren (561.41 – 37.50).
10. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 93/2006, date 20.02.2006, (Ish), Rr. Gani Çavdërbasha, nr. 12, në Prizren (692.53 – 37.50).
11. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E. nr. 120/2006, date 20.02.2006, (IK), F.Nashec, Prizren, (313.43 - 25.00).
12. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 1244/2006, date 20.02.2006, (ShK), Rr. Vrrinit, nr. 26, Prizren, (865.94 – 37.50).
13. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 271/2006, date 04.04.2006, (AK), Rr. Ismet Jashari-Kumanova, E.nr. 83, Prizren (412.59 – 25.00).
14. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 274/2006, date 04.04.2006, (EO), Rr. Shtjefën Gjeqovi, pn. Prizren, (440.53 – 25.00).
15. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 276/2006, date 04.04.2006, (RE), Rr. Tiranës, pn. Prizren (422.88 - -25.00).
16. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 282/2006, 04.04.2006, (HL), Rr. Udha e Shkronjave, nr. 5, Prizren,(454.62 – 25.00).
17. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 292/2006, 04.04.2006, (MM), Rr. Bingenit, nr. 8/a, Prizren, (444.91 – 25.00).

18. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 303/2006, date 04.04.2006, (SK), Rr. Ersan Mazreku, nr. 24, Prizren (634 – 37.50).
19. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E .nr. 324/2006, Datë 04.04.2006, (XHB), Rr. Carraleva, nr. 54, Prizren (431.42 – 25.00).
20. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E,nr. 325/2006, datë 04.04.2006, (ShA), Rr. Zona e Pashtrikut, nr. 35, Prizren (363.11 – 25.00).
21. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 355/2006, date 04.04.2006, (MB), Rr. Bulevardi i Rinisë, pn.Prizren, (1.91 – 37.50).
22. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 358/2006, date 04.04.2006, (RB), Rr. Janinës, nr. 34, Prizren (497.80 – 25.00).
23. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 361/2006, date 04.04.2006, (GE), Rr. Janinës, pn. Prizren, (411.04 – 25.00).
24. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 372/2006, date 04.04.2006, (ML), Rr. Carraleva, nr. 44, Prizren, (613.58 – 37.50).
25. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 375/2006, date 04.04.2006, (BM), Rr. Trepça, nr. 11/a, Prizren, (568.04 – 25.00).
26. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 657/2007, date 21.02.2007, (SB), Rr. Pervezës, nr. 12, Prizren (690.87 – 37.50).
27. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 668/2007, datë 18.11.2014, (IL), Rr. Nëna Terezë, nr. 12, Prizren, (1198.46 - 20.00).
28. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 670/2007, datë 08.02.2007, (MBAUF), Rr, U.Ç.K. pn, Prizren, (833.33 – 37.50).
29. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 873/2007, date 18.11.2014, (JH), Rr. Rifat Krasniqi, nr, 41, Prizren (200.04 – 15.00).
30. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 885/2007, date 18.11.2014, (MJ), Market-Frizer, Rr, Shote Galica, pn. Prizren, (364.73 – 15.00).
31. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 887/2007, datë, 27.02.2007, (VE), Rr. Qylhani i Vjetër, nr. 15, Prizren(489 - -25.00).
32. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 891/2007, date 18.11.2014, (ZP), Rr. Shote Galica, nr. 30. Prizren (269.11 – 15.00).
33. Me datë 16.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr. 894/2007, date 18.11.2014, (ZM), Rr. Zahir Pajaziti, pn. Prizren, (207.12 – 15.00).
34. Me datë 19.10.2015, nga Gjykata Themelore është sjellë Aktvendim sipas të cilit përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit për Faljen e Borxheve lidhur me lëndën E.nr.684/2007, date: 15.10.2015, (AQ) nga Prizreni, Rr. “Jusuf Gervall” nr.4, (323.57 - 37.5);

